



**FKPKK**

Federata Kombëtare e  
Pyjeve dhe Kullotave  
Komunale, Shqipëri

www.shkpkk.org

# Kurora e Gjelbër



**APPK**

Asosacioni i  
Pronarëve të Pyjeve  
Privatë, Kosovë

www.akppp.org

Gazetë Periodike, Tiranë (Viti i katërbëdhjetë i botimit) Nr. 116, maj 2012 Çmimi 20 lekë

## Regjistrimi i Pyjeve dhe Kullotave si prona të transferuara tek Njësitë e Qeverisjes Vendore

- Fjala e Ministrit Mediu në seminarin për pronat -  
Tiranë me 25.04.2012

**M**inistria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave, ka qenë dhe është angazhuar për vazhdimin pandërprerje të procesit të decentralizimit, transferimit e privatizimit të pyjeve, duke e vlerësuar si një nga reformat më të rëndësishme në sektorin e pyjeve.

Nga ana tjetër, kemi bindjen se procesi i transferimit është vetëm hapi i parë i rëndësishëm, i cili duhet pasuar me hapa të tjerë, po aq të rëndësishëm, si psh, procesi i regjistrimit të pasurive natyrore nga njësitë e qeverisjes vendore. Vetëm regjistrimi krijon kushte reale për zbatimin e një menaxhimi të qëndrueshëm dhe i hap rrugë zbatimit të mekanizmave për përfitime ekonomike.

Grupi i Punës për përshpejtimin e procesit të transferimit/privatizimit të pyjeve e kullotave, i



ngritur pranë MMPAU, po punon për të hartuar platformën dhe përcaktuar metodologjinë për vazhdimin e procesit të decentralizimit/privatizimit të pyjeve.

*Vijon në fq. 2*

## Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të NjQV-ve

### PROBLEM I VËSHTIRË APO I NEGLIZHUAR?

Gjon FIERZA, Specialist për pyjet në DSHP, Tiranë - Janaq MALE, Specialist për pyjet në SNV, Tiranë

**T**ransferimi i pyjeve dhe kullotave shtetërore tek Njësitë e Qeverisjes Vendore, është një hap i rëndësishëm drejt procesit të decentralizimit, i cili synon të rrisë pjesëmarrjen e komunitetit në kujdestarinë për burimet natyrore dhe të nxisë zhvillimin lokal në zonat rurale e malore. Edhe pse Këshilli i Ministrave në vitin 2008 ka aprovuar transferimin e

624.985 ha pyje dhe rreth 142.280 ha kullota tek NjQV, vetëm një sipërfaqe e kufizuar është regjistruar. Në baze të rregulloreve ekzistuese, transferimi në pronësi nuk quhet i kompletuar pa bërë regjistrimin e pronave nëpërmjet autoriteteve përkatëse. Përfundimi i procesit të transferimit të pronave është penguar

*Vijon në fq. 6*

## Me kujdesin e komunitetit pyjet do të marrin zhvillim të qëndrueshëm

Projekti i ri: Komuna "pronare", do t'i shpëtojë pyjet nga shkatërrimi



Intervistë e  
Ahmet  
MEHMETIT,  
inxhinier në  
Ndërmarrjen  
Pyjore  
Elbasan

Kalimi i pyjeve shtetërore në pronësi të qeverisjes vendore dhe komunitetit, ndihmon në zhvillimin e pyjeve. Projekti do të bëjë që të mbrohen më shumë nga abuzimet, thotë midis të tjerash për gazetën "Telegraf", inxhinieri i pyjeve Ahmet Mehmeti, specialist me përvojë në Qarkun e Elbasanit. Më tej ai flet për rëndësinë e këtij kalimi, për resurset e zonës dhe përse

Era ÇELA

është i rëndësishëm ky kalim në pronësi të qeverisjes vendore e komunitetit, për mbrojtjen e tyre dhe për një zhvillim të qëndrueshëm. Gjatë intervistës ai vë në dukje punën e komunave si "pronare" të pyjeve, por edhe për atë që në komuna ka akoma probleme me kufijtë administrativë.

*Vijon në fq. 4*

## Pylli dhe reformat në realitet dhe në Gazetë

**D**ebati i hapur në gazetën "Kurora e Gjelbër" dhe në faqet e medias sociale në lidhje me atë se ç'po ndodh me reformën e pyjeve në vendin tonë, indirekt është një diskutim që flet për funksionimin e demokracisë sonë. Jo vetëm se vetë media është një nga "pushtetet" e demokracisë, por edhe se përmes saj shoqëria (opinionit publik) realizon kontrollin e saj mbi pushtetet e tjera. Është pikërisht kjo, që i jep asaj autoritetin dhe karakteristikat e një pushteti real. Me fuqizimin e medias elektronike, me përhapjen e internetit dhe burimeve të tjera të informacionit, që sa vjen e bëhen më globale, pa dyshim lypset që edhe media e shkruar për PYLLTARINË të përshkruajë me këtë realitet të ri. Brenda këtij "pushteti" tashmë, roli i shtypit të shkruar e posaçërisht i Gazetës "Kurora e Gjelbër", mbetet specifik. Pavarësisht se media elektronike ka një ndikim publik më të gjerë, nëse do të duhet të kërkosh një analizë të thelluar opinionbërëse, atëherë si kudo në botë, duhet t'i drejtohesh shtypit të shkruar. Gazeta në fakt shërben jo vetëm si informuese po edhe si opinionbërëse. Artikullshkruesit pretendojnë të përmbushnin misionet, nëpërmjet publikimeve dhe kjo duket me faktin se Gazeta "KGJ" po kërkohet jo vetëm në Shqipëri po në të gjitha vendet e rajonit, krahas vëllezërve tanë në Kosovë. Duhet pranuar se debatet kanë qenë të pranishme dhe përplasja e mendimeve të ndryshme, po ashtu ka qenë një vlerë e shtuar. Por, në mënyrë paradoksale, si represion ndaj kësaj Gazete, disa struktura shtetërore, me të cilat botuesit kishin edhe kontratë zyrtare, e neglizhuan mbështetjen financiare. Por, Federata Kombëtare vazhdon ta botojë e ta kthejë këtë gazetë në tribunë reale për jetën e zhvillimin e pylltarisë në përgjithësi dhe të asaj komunale në veçanti. Së shpejti në faqet e saj do të publikojmë fakte

*Vijon në fq. 2*

## E kaluara dhe e ardhmja e Rugovës

nga Ramiz QORRAJ

Fq. 4

## Turizmi rural në Kosovë ...

nga Ardita DINAJ

Fq. 5

## Ilmi GJANA Tradita vazhdon

Në  
*Bjeshkët  
e Kukësit*

Fq. 7

*Jeta në stane gjatë verës*



## Regjistrimi i Pyjeve dhe Kullotave si prona të transferuara tek Njësitë e Qeverisjes Vendore

Vijon nga fq. 1

Procesi i transferimit të pyjeve dhe kullotave vazhdon pa ndërprerje në 316 Njësi të Qeverisjes Vendore:

1. Janë përgatitur projektvendimet, me bashkëfirmosje, për ndryshime në listat e inventarit të pyjeve e kullotave në 16 NjQV, për plotësimin e kërkesave shtesë për pyje e kullota, bazuar në kufijtë tradicionalë të përdorimit.
2. Për të përshpejtuar procesin, MMPAU ka hartuar e shpërndarë të gjithë praktikën ligjore të administrimit të pyjeve e kullotave komunale dhe, shërbimi këshillimor në pyje, po nxit, mbështet e këshillon NjQV dhe shoqatat e përdoruesve të pyjeve e kullotave, duke rritur kapacitetet.
3. Janë bërë saktësime në listat paraprake dhe ato përfundimtare të pyjeve e kullotave, objekt i projektvendimeve të Këshillit të Ministrave, për 46 NjQV dhe po bashkëpunohet për plotësimin e gjithë kërkesave për shtimin e sipërfaqeve pyjore e kullotave në pronësi të tyre.

MMPAU ka miratuar e po miraton të gjitha kërkesat e komunave për transferimin e pyjeve dhe kullotave, të përcjella sipas praktikës ligjore nga Ministria e Brendshme.

Është theksuar edhe herë të tjera sa procesi i transferimit të pyjeve nuk duhet konsideruar si proces i thjeshtë transferimi, as si transferim i përgjegjësive të komunat, por si proces që synon përfshirjen e gjithë aktorëve në menaxhimin e qëndrueshëm dhe afrimin e pyllit të komuniteti.

Kompleksiteti i problemit është lehtësuar nëpërmjet:

- Hartimit të një kuadri ligjor të qartë e të plotë, i cili lejon dhe mbështet të gjitha veprimtaritë që lidhen me mbarëshkrimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale, përfshi të drejtat e pronësisë e të përdorimit; të drejtat për mbarëshkrimin dhe shfrytëzimin e pasurive pyjore e kullotave komunale; të drejta për përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve dhe parketimin e shërbimeve; të drejtat për mbledhjen e gjobave dhe taksave, si dhe administrimin dhe riinvestimin e fondeve publike e private në këtë sektor.



- Hartimit të planeve të menaxhimit të pyjeve komunale me bazë komuniteti në të gjitha komunat që kanë përfituar nga transferimi.
- Akordimit të paketave për zbatimin e planeve të menaxhimit për tre vitet e para, të kryera nga shoqatat e përdoruesve të pyjeve.
- Nxitjes (edhe financiarisht) së procesit të krijimit, forcimit e funksionimit të shoqatave të përdoruesve të pyjeve komunale dhe konfederatës së tyre.
- Krijimit të shërbimit këshillimor pyjor, i cili po asiston në komuna në drejtim të rritjes së kapaciteteve.

Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore (NRDP/WB), i fokusuar në zhvillimin e pylltarisë komunale, ka pasur objektin të përgjithshëm forcimin e qeverisjes së burimeve natyrore me bazë komuniteti, mbështetjen e menaxhimit të burimeve natyrore, uljen e shkallës së erozionit dhe sekuestrimin e karbonit. Kjo ka çuar në rritjen e të ardhurave e prodhimit pyjor, që burojnë nga:

- i. Mbarëshkrimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore,
- ii. Ulja e degradimit të tokës,
- iii. Përmirësimi i menaxhimit të ujërave,
- iv. Konservimin e biodiversitetit,
- v. Forcimin e sektorit publik të menaxhimit të këtyre burimeve.

Në këtë kuadër, objektivi lidhur me transferimin nga 450.000 ha (138 komuna) u përmirësua në 660.000 ha dhe u realizua në mbi 700.000 ha (318 komuna).

Komponenti i sekuestrimit të karbonit, përveç se krijoi të ardhura për shoqatat, që morën pjesë në të, krijoi konceptin e pagesave për shërbime në ekosistem, filozofia e projektit të ardhshëm.

Duhet theksuar fakti se objektivi lidhur me regjistrimin, i planifikuar për t'u zhvilluar në 218 komuna, është realizuar vetëm në 5 komuna (2 %), lidhur kjo vetëm me dëshirën minimale të komunave për të realizuar këtë proces. Ky fakt, si dhe dëshira për

të mos e transferuar te përdoruesi i fundit, ka ulur ndjeshëm efektivitetin e projektit dhe potencialin e të ardhurave në interes të komunitetit:

- Pyllëzime të dështuara ose me përqindje zënieje mjaft të ulët,
- Investime në përmirësime pyjesh (rrallime) pa evidentuar asnjë të ardhur nga materiali drusor i vjelë,
- Sisteme malore të shkatërruara menjëherë mbas shirave të para.

Të gjitha këto mangësi e kanë burimin te mungesa e përdoruesve legalë të këtyre pyjeve, çka bën të pamundur vendosjen e sistemit të monitorimit dhe shpërblimit periodik për shërbime në ekosistem.

Megjithëse procesi i transferimit vijon në mënyrë dinamike, ai shoqërohet me problem e pengesa të shumta:

1. Endë nuk ka të përcaktuar kufij ligjorë administrativë ndërmjet komunave, çka shpesh krijon konflikte mes komunave. Mungesa e tyre ka sjellë probleme në përcaktimin e të drejtës mbi përkatësinë e pyjeve dhe kullotave ndërmjet komunave. Komunat në konflikt ndërmjet tyre kërkojnë t'i zgjidhin pretendimet nëpërmjet MMPAU, edhe kur ato kalojnë përtej kompetencave të kësaj të fundit. Vlen të theksohet fakti se ekzistojnë konflikte lidhur me përkatësinë e pyjeve, ndërmjet komunave (kryetarëve), konflikte që nuk ekzistojnë ndërmjet fshatrave ose fshatarëve (përdoruesve tradicionalë).
2. Procesi i regjistrimit vazhdon të mos funksionojë, ndërkohë që SNV, me fonde të SIDA-s, po vazhdon të evidentojë problematikën lidhur me regjistrimin në 12 komuna-pilot. Nënvizojmë se ndonëse Qeveria me vendim të veçantë hoqi të gjitha tarifën e shërbimeve, drejtuesit e NjQV vazhdojnë të mos e vlerësojnë këtë proces.
3. Shpesh mungon bashkëpunimi midis NjQV me shoqatat e përdoruesve të pyjeve e kullotave për të rritur interesin dhe shkallën e ndërgjegjësimit të komunitetit. Me keqardhje vërejmë se ka prirje për t'i shmangur këta aktorë aktivë të krijuar në komuna.
4. Konstatojmë se një pjesë e komunave kanë bërë tjetërsime të pyjeve, të cilat bien ndesh me kriteret e përdorimit, të përcaktuara në ligje e vendime. Kjo prirje është rritur kohët e fundit.

DPK vazhdon bashkëpunimin me komunat dhe organizimin e takimeve në nivel prefekturash e qarqesh, për të ndjekur në dinamikë procesin dhe zgjidhur në kohë problemet e hasura.

## Pylli dhe reformat në realitet dhe në Gazetë

Vijon nga fq. 1

që flasin për ata që u bënë pjesë dhe keqpërdorën pushtetin, vetëm për të mbrojtur veprimet e tyre të dyshimta, po të pashpresa.

Në botë profesionet që përmbushin misionin janë të pakta; mund konsiderohet ai i mësuesisë, priftërisë dhe i gazetarit e, megjithatë, janë ndër punonjësit më të keqpagaruar, duke përmbushur kësaj veçoritë e një shoqërie të "papërgjegjshme", siç është edhe kjo që dëshirojmë të ndërtojmë më së shumti me mentalitetin tonë thellësisht ballkanik ...

Misioni i kësaj Gazete është përcjellja e mendimit paraprakisht të shoqërisë apo, si të thuash opinionbërës apo opinionformues, mendim që të ndjehet edhe përgjegjës për realitetin, për atë çka ndodh ose edhe që do të ndodhë. Po, ja, mund të thotë dikush "pushteti nuk do t'ia dijë për ç'thua", pesha e fjalës ka rënë, shoqëria reagon pak ndaj papërgjegjshmërisë së individëve pa mision. Kjo është e vërtetë sepse ndodh edhe në

shoqëritë më të stabilizuara e demokratike, ëndrra e pushtetit ka qenë dhe mbetet korruptimi i "pushteteve të tjerë", por kjo s'është thotë që lufta dhe përpjekjet e shoqërisë të pakësohen dhe roli i gazetës e i shoqërisë të pushojë së vepruari.

Nëse kemi këtë situatë të pyjeve e mjedisit, nëse informaliteti vazhdon, nëse ligjet nuk zbatohen, nëse jetesa është vështirësuar dhe varfëria është rritur, si mund të punojnë e kontribuojnë gazetarët për përmirësimin e gjendjes, kur s'kanë asnjë statistikë të besueshme përpara (veç ndonjë raport të institucioneve ndërkombëtare). Pra, në këtë situatë s'ka si të ecë edhe shtypi e media në përgjithësi.

Po Gazeta "Kurora e Gjelbër" a do të vazhdojë më me këtë ritëm? Nëse këto pushtete "dorëzohen", pra "blihen e shiten", atëherë shkaku duhet kërkuar tek ata që "shiten e blihen"! Apo thënë ndryshe: "Ata që pranojnë të vihen në shërbim të kujtdo, jo për shkak të politikave, po për afera korruptive në rastin më të keq apo edhe interesave klanore, në rastin më të mirë".

Para disa ditësh, një mik i Federatës, që drejton një fakultet, duke debatuar (ndoshta me të drejtë për shkak të informacionit që kishte), arrin të mohojë disa nga arritjet e këtyre 20 vite, që lidhen me reformat dhe pyjet komunalë në Shqipëri.

## Dy qengja ose dy keca, të dy meshkuj ose të dy femra! (Ky ishte krahasimi që një drejtues i pylltarisë më të suksesshme në Shqipëri, i bëri reformës për pyjet sot, pas 20 vitesh demokraci)

Federata Kombëtare ka kërkuar në vazhdimësi të përfshijë në debate, diskutime e studime shumë nga profesorët me përvojë në pylltarinë shqiptare. Dhe, nga shumë analiza e studime kanë dalë mjaft rekomandime për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave. Një kërkesë e ligjshme e të gjithë pronarëve e përdoruesve tradicionalë ka qenë dhe mbetet pronësia mbi tokën. Tashmë lypset të vendoset përfundimisht se cilat janë tokat në pronësi private, cilat në përdorim të përbashkët dhe cilat shtetërore, për të shmangur edhe kundërshtimet që do të lindin e do të nxjerrin vështirësi, që nuk do të jetë e lehtë të kapërcehen nga qeveria. Nuk është serioze psh, që askush nuk di me saktësi sa ha pyje e kullota ka aktualisht, sa rriten e sa priten, sepse mungojnë analizat e përditësimet edhe pse paguhen nga taksapaguesit një numër jo i pakët ekspertësh. Pastaj, pasi të studiohet e vërtetohet me hollësi gjendja, mund të diskutohet si të planifikojmë shfrytëzimet dhe të

ardhurat. Ku? Sa? Shumë e krahasojnë pyllin me thesarin, po sa ka në thes asnjë s'përgjigjet.

Si në kohën e Turqisë edhe sot në kohët moderne, rreziku më i madh, që po kërcënon deri në humbje, jo vetëm pyllin, po edhe vetë tokën, është mungesa e të kuptuarit dhe të vlerësuarit të problemit e harmonisë së njeriut me tokën dhe e ligjërit të këtyre raporteve. Zyrtarët e ftohtë urbanë, skllëvër të sloganeve fikse, krijojnë konfuzion në të gjitha shtresat e shoqërisë, fusin në konflikt popullsinë urbane me atë rurale. Shumica e të shkolluarve, pavarësisht nga specialiteti, janë të mbyllur në sloganin "mbron pyllin", duke luajtur patriotin e krijuar një ç'orientim të madh në gjithë shtresat shoqërore e veçanërisht tek vendimmarrësit.

Kjo politikë e gabuar e pronësisë mbi tokën, nënvlehtësimi i nevojave dhe planifikimi jo real i tyre, kombinuar me prapambetjen ekonomike e sociale dhe ndjeshmërinë tepër të madhe të sistemeve të brishta ekologjike, janë ndër shkaktarët e këtij degradimit intensiv në pyje. Një pjesë e faktorëve, veçanërisht pronësia dhe edukimi, është në duart e shoqërisë, e cila ka përgjegjësi për ruajtjen e tokës për brezat që do të vijin ...

Vijon në fq. 3

# PËR PRONËSINË DHE MENAXHIMIN E KULLOTAVE TË JUGUT

Vjola ELEZI - Association Building Specialist, United Nations Development Programme (UNDP)



## Të dhëna të përgjithshme

**K**ullotat dhe livadhet në jug të Shqipërisë, zënë një sipërfaqe të konsiderueshme dhe janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme me pyjet. Kjo dikton edhe mënyrën e menaxhimit në kompleksin e menaxhimit dhe administrimit të tyre. Në përgjithësi kullotat janë gjithëvjetore të ekonomisë kullorë "Konispol" deri në Vlorë. Këto kullota sot përfaqësohen nga sipërfaqe të tëra të mbuluara me bar. Por, meqë prej disa vitesh nuk kryhet asgjë për përmirësimin e kullotave, ato shpesh mbulohej me shkurre të dëmshme. Prandaj banorët përdorin zjarret për pastrimin e tyre, për të krijuar mundësi që të ripërtërihet barit për sezonin e vjeshtës. Në këtë sistem kodrash, të mbuluara me kullota, kulloshin tradicionalisht bagëtitë e gjithë komuniteti, por për vite me radhë, DSHP i ka dhënë me qira sezonale edhe për klientë jashtë komunës.

## Kullotat dhe blegtoria

Vetë pozicioni i kullotave në shumë Komuna, bën që të kemi kullota verore, por edhe gjithëvjetore tipike. Deri sot autoritetet e komunës kanë qenë pa influencë në menaxhimin e këtyre kullotave, duke pësuar vetëm pasojat e këtij aktiviteti, ndërsa për DSHP-në e Sarandës dhe të Vlorës ka ndikim më të madh në bilancin ekonomik. Vendimi i KM për kthimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të komunës, i vendos autoritetet e komunës dhe komunitetin në pozicionin e përgjegjës dhe zgjidhës të problemit kryesor të menaxhimit të këtyre kullotave. Natyrisht, procesi i transferimit dhe regjistrimit akoma vazhdon në shumë komuna. Siç u theksua më lart prioriteti i komunës

## Vijon nga fq. 2

Ekspertët dhe popullsia janë në konfuzion. Media, bashkë me politikën, as që e kuptojnë se eksperti dhe asistencë financiare bëhen të panevojshme për një sistem nga i cili nuk kërkohet prodhim. Për të gjithë opinionin publik prerja e drurëve, pa bërë dallimin ku dhe për çfarë, pa ditur që prerja është formë e menaxhimit, aktualisht trajtohet si kasaphanë. Pra, është e vështirë të krijohet një bazë ekonomike e mjaftueshme për t'u dhënë njerëzve atë cilësi jetese që meritojnë, si dhe një qeverisje të bazuar mbi konceptin progresiv të ndarjes së pasurisë. Kjo ende nuk ka ndodhur dhe është e vështirë për t'u realizuar me politikën e viteve të shkuara, kur thuhej "t'u jepen fshatarëve "dy qengja ose dy keca, po të dyja femra ose të dyja meshkuj, se ndryshe pjellin kapitalizëm". Kjo është e evidente edhe kur përpiqesh të fajësosh personat e pushtetshëm apo politikën, që vazhdon të

është blegtoria dhe ekoturizmi e, për pasojë, duhet një kthesë rrënjësore, për të përmirësuar këto kullota, ku krahas ekoturizmit të zhvillohet edhe blegtoria, si një nga mjetet për të komplementuar zhvillimin e kësaj dege të turizmit. Kushtet klimatike dhe tokësore favorizojnë zhvillimin e bujshëm të bimësisë pyjore dhe asaj barishtore, por faktikisht kapaciteti mbajtës i blegtorisë në to është mesatar. Në pjesën më të madhe të ngastrave, kullotat e rënduar mbi kapacitetin mbajtës ka çuar në uljen e prodhimtarisë dhe degradimin e bimësisë barishtore. Pjesa më e madhe e këtyre kullotave shfrytëzohen më tepër në pranverë e vjeshtë. Kapaciteti mbajtës i kullotave (krerë/ha) është mesatarisht 8 krerë të leshta, 4 të dhirta dhe 0.8-1 gjedhë.

Duke parë se pjesë e aktivitetit kryesor e me perspektivë për popullatën vendase mbetet blegtoria, zhvillimi i saj, duhen studime të thelluara, duke i dhënë përparësi studimit të gjendjes së kullotave, masave përmirësuese, si dhe mbështetjes me investime.

Tre janë problemet e mprehta teknike, që kërkojnë zgjidhje në kullotat e jugut, sipas një vështrimi të përgjithshëm dhe takimeve diskutuese: (i) Sigurimi i ujit të pijshëm për bagëtitë, (ii) Kullotat e planifikuar e rotacioni, (iii) Struktura e bimëve të kullotave me bimë të ngrënshme e të dëmshme, që kanë nevojë për ndërhyrje me investime.

## Qëllimi dhe përmbajtja e takimeve

Me 16 mars të këtij viti, në kuadër të projektit "Përmirësimi i performancës së sektorit të blegtorisë në Shqipëri" në rrethin e Sarandës u zhvillua takimi i dytë me temë "Përmirësimi i Menaxhimit të Kullotave dhe Burimeve Ujore" në rrethet e Sarandës dhe Delvinës, zona ku zhvillon aktivitetin Shoqata e Blegtorëve "Qengjat e Jonit". Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nga DSHP, Sarandë e Delvinë, nga Zyra këshillimore e Bujqësisë, Sarandë, nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA), nga Shoqata Kombëtare e Blegtorëve LEAA, nga shoqata e Blegtorëve "Qengjat e Jonit", me përfaqësues nga Saranda, Delvina, Finiqi, Lukova, Xara, Federata Kombë-

mbajë të "korruptuar" procesin (dhe jo vetëm). Problemi kryesor i medias është pikërisht brenda tyre. Pra atje, brenda tij, janë arritjet dhe po atje duhet të kërkohen edhe dështimet. Teorizimet vetpërkëdhelëse se për gjendjen e keqe të pyjeve e të tokës, apo erozionin e shtuar e ka fajin fshatari dhe "po t'i japim pyllin ai do ta presë", "ai është ku e ku i korruptuar, mediokër e korruptues", s'janë tjetër veç një mënyrë justifikimi e pseudospecialistëve dhe pseudopolitikanëve, që nuk mund ta gjejnë veten në treg, po përpiqen me metoda demagogjike nën petkun e partive, të rrezikojnë e deformatojnë gjithë procesin dhe rezultatet e gjithë këtyre viteve. Roli i gazetës "Kurora e Gjelbër" është t'u japë të gjithëve, qytetarëve, ekspertëve, fermerëve e kujtdo, informacionin e duhur për të bërë gjykime të drejta e të mençura rreth njerëzve e probleme që ndeshin e prekin në jetën e përditshme. Nëse duam të kemi shoqëri demokratike, kjo nuk mund të jetë shoqëri e paditur.

tare e Pyjeve dhe Kullotave Kombëtare. Qëllimi i takimit ishte njohja dhe qartësimi i të drejtave për pronën (pyje e kullota), bazuar në aktet aktuale ligjore e nënligjore.

Takimin e hapi **Ornela Gjika**, koordinatore kombëtare e projektit të UNDP-së, e cila u uroi mirëseardhjen të pranishmeve, paraqiti agjendën e takimit dhe shpjegoi qëllimin e zhvillimit të këtij takimi. Më pas ajo ia dha fjalën **Tatjana Dishnicës**, drejtore pranë Drejtorisë së Shërbimit Këshillimor në Ministrinë e Bujqësisë. Më pas, **Dashmir Aliu**, shef i Shërbimit Këshillimor, Sarandë dhe **Feim Rexho**, menaxher i Shoqatës së Blegtorëve "Qengjat e Jonit" paraqitën gjendjen e lerave në kullotat e rretheve Sarandë e Delvinë. **Alban Qinami**, specialist pranë MADA-s, paraqiti mënyrat e vlerësimit teknik dhe kriteret e selektimit të listës së shkurtuar të lerave në kullotat e Sarandës dhe Delvinës. Pastaj fjalën e mori **Valbona Ylli**, drejtore ekzekutive e Shoqatës së Blegtorëve LEAA, e cila paraqiti modelet e gardheve elektrike, përfitimet dhe përmirësimi i kullotave nëpërmjet përdorimit të tyre. **Rexhep Ndreu**, kryetar i Federatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale të Shqipërisë, prezantoi kuadrin ligjor kombëtar për administrimin e pyjeve dhe kullotave.

Pas këtyre paraqitjeve, u diskutuan e u përcaktuan prioritetet për ndërhyrjen dhe përmirësimin e burimeve ujore të kullotave dhe modelet e gardheve elektrike. Po ashtu, u diskutuan përfundimet që dolën nga ky takim. Ishin të shumtë ata që pyetën e kërkuan sqarime lidhur me të drejtat e komunës dhe të anëtarëve të Shoqatës për pronësinë e pyjeve dhe kullotave. Në këto rrethe ka pasur raste shumë të shpeshta për kontratat e paqarta dhe me shumë përdorues, duke shkelur të drejtat e përdoruesve tradicionalë.

Pas këtij takimi, u zhvilluan edhe tre të tjera, në Sarandë (10-11 prill) me përfaqësues të shoqatës së Blegtorëve "Qengjat e Jonit" nga Delvina e Saranda (Xarrë, Konispol, Vergo, etj). Qëllimi ishte ndërgjegjësimi i aktorëve të përfshirë në proces për transferimin e pyjeve dhe kullotave pranë NjQV.

Njerëzit duhet të dinë se ajo që lexojnë ose shikojnë është e verifikuar, prandaj, jo pa qëllim në të gjitha numrat e Kurorës publikohen modele të pyjeve të fermerëve, veprimet dhe aksionet e Shoqatave, Federatave dhe individëve të veçantë. Publikojmë atë që bëjmë, atë që prekim që prej pesë vjetësh, nga Vermoshi në Sarandë. Me të drejtë një bashkëpunëtor për pyjet para ca kohësh shprehte mosbesim dhe disa të tjerë guxonin edhe të akuzonin se këto nuk janë punët tona, të Federatës. Por, nëse kjo përsëritet edhe kur ne e shprehim qartë, me zë e me figurë, me të shkruar, atëherë pse nuk beson ti ... s'të ka faj kush, por kjo ndodh kryesisht tek njerëzit që nuk duan të zhvillojnë reformat dhe të bashkohen me mendimin dhe kërkesat e fermerëve se pyjet janë e do të jenë pronë e tyre dhe fermerët janë pronaret e TYRE.

Ne jemi të paanshëm dhe gazeta jonë është e paanshme. Ne verifikojmë dhe jemi pjesë e asaj që behet në terren. Ne



## Objektivat e këtyre takimeve ishin:

- Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi mbi objektivin dhe rolin e pyjeve dhe kullotave komunale.
- Të kuptuarit e hapave të nevojshëm për transferimin e pyjeve e kullotave dhe zhvillimi i planit të menaxhimit.
- Pse pyje dhe kullota komunale?
- Ç'është menaxhimi i pyjeve dhe kullotave?
- Si të marrim pyje dhe kullota komunale?
- Roli i aktorëve të përfshirë në proces.

Në këto takime, sipas agjendës së planifikuar, **Rexhep Ndreu**, kryetar i FKPKK, paraqiti funksionet e ndryshme të pyllit (prodhues, mbrojtës, mjedisor e social), si dhe rëndësinë e tyre për njerëzit, që i përdorin e përfitojnë prej tyre. Po ashtu, ai dha një panoramë të shkurtër të pylltarisë shqiptare ndër shekuj dhe arsytet pse duhet që procesi i transferimit të pyjeve dhe kullotave pranë NjQV duhet të vazhdojë. Pjesë e prezantimit ishin edhe hapat që duhen ndjekur për kalimin e këtyre pasurive, si dhe rolin që kanë DSHP, Shoqatat e Përdoruesve dhe fermerët.

Prezantimet u shoqëruan me pyetje e diskutime nga të pranishmit, ku u shprehën pakënaqësi për mënyrën e ndarjes së kullotave, për mungesën e vendimeve për to dhe se ka raste kur shoqata grumbullon tarifa, si dhe ka mungesë transparence.

Takimet u zhvilluan me mbështetje të Projektit të UNDP, financuar nga Delegacioni Evropian Kooperimi Italian.



nuk veprojmë me të dëgjuar, pa e provuar. Në përcjellim praktika e përvoja reale, të dukshme e të prekshme për të gjithë. Ai që se beson sot do të besojë nesër dhe për këtë jemi të bindur, por atëherë do të jete vonë ... E kush humbet? Te gjithë, njeriu, pylli, toka, mjedisi, ajri, ekonomia dhe zhvillimi i qëndrueshëm ...

Mos vallë jemi të gjithë pjesë e një realiteti ku pushtetet janë përzierë keq me njëritjetrin dhe e ke të vështirë të ndash më vete politikanin nga eksperti, gazetarin nga pushteti, pylltarin nga biznesmeni? Që këtej dalim tek ai që quhet "mision". A ka një mision institucioni ku bën pjesë? A ka një mision Federata? Po shtypi? E, për cilindo që merret sadopak me këto punë, është e qartë se ka një diferencë jo të papërfillshme mes të qenit misionar dhe të qenit pjesë organike e një realiteti që sa vjen e më shumë korrupton e korruptohet.

## Federata Kombëtare e PKK

# E kaluara dhe e ardhmja e Rugovës

nga Ramiz QORRAJ

**K**rahina e vogël malore e Rugovës përfshinë diku 4300 ha toke dhe shtrihet në vargmalet e Alpeve Shqiptare, e cila, sipas disa shënimeve, del e banuar që nga viti 1485, por sipas vlerave historike, shpirtërore e kulturore, duhet të ketë qenë banuar edhe shumë më herët, është dhe mbetet nja nga vlerat e mëdha fundamentale të kombit tonë, vlera këto që na i dhuroi natyra dhe patëm fatin që të na takojnë.

mënyra e të jetuarit, përbejnë një zonë mjaft interesante, e cila edhe në të kaluarën studiohej nga studiues të fushave të ndryshme. Kjo trevë në gjirin e vet ka 13 fshatra të shpërndarë malorë, ku fshati prej fshati është larg deri në 20 km. Kjo trevë, në një të kaluar të afërt kishte diku afro 8000 banorë, kishte një fond të madh bagëtish, si dhe dy shkolla tetëvjeçare me 10 paralele të ndara me afro 500 nxënës. Por edhe pse kjo

vetmja infrastrukturë në këtë mes ishin shkollat, tre - katër dyqane, dy kafene e dy ambulanca. Gjithashtu, filloi marrja e pronave nga shteti, duke i shpallur pronat që këta banorë i mbanin me shekuj. Pastaj, kinse, në baze të disa ligjeve që i shkruanin siç donin vetë, këtyre ardhacakëve u jepej nga pak pronë për mbajtjen e familjeve, ndërsa pjesa tjetër mbetej kontest, konteste këto që janë bartur deri më sot dhe që duhet sa më parë shteti i ri i Kosovës t'i zgjedhë në favor të këtyre banorëve, kuptohet, në rastet kur ka fakte. Për këtë banorët e kësaj treve, në fakt pronarët, vetëm kanë filluar një studim për pronat e kontestueshme, gjë që po mbështetet edhe nga donatorët e huaj, siç është SNV-ja dhe mendojmë të arrijmë të paktën t'u tregojmë përfaqësuesve të institucioneve tona përmes këtij studimi, që përfshin të gjitha dëshmitë dhe dokumentet e pronarëve që tregojnë qartë se kujt i takojnë ato dhe argumentojnë atë për çka edhe luftojnë banorët e kësaj treve. Në kushte dhe rrethana të këtilla filloi braktisja e heshtur e popullatës nga kjo treve dhe zbritja për në rrafsh, në kërkim të kushteve më të mira jetese.

Në këto kushte e rrethana filloi shpërngulja sistematike, që nga vitet '80 të shekullit të kaluar. Pastaj, lufta e fundit u shkatërroi rugovasve gjithçka kishin bërë me mund e sakrificë gjatë shekujve. Pothuaj s'mbeti asgjë nga puna dhe jeta e tyre. U tretën pasuri dhe vlera të shumta arkitektonike, historike e kulturore. Përkundër gjithë kësaj, rezistuan ato mbivlera që nuk mund



Kur flasim për Rugovën menjëherë përpara na del, na shfaqet, një bukuri e rrallë, e cila në vete ndryshon një ashpërsi të fshehur, që reflekton nga vetë natyra dhe jeta në këto male. Na del përpara malësori me veshjen karakteristike, me shallin rreth koke, me një kalë të ngarkuar me dru, duke zbritur në qytet për të sfiduar vështirësitë e shumta të jetës. Kjo trevë me traditat, doket e zakonet, me virtutet e larta, që e dallojnë, si trimëria, mikpritja, besa, bujaria, gjuha, veshja, ushqimi,

trevë kishte të gjitha këto vlera, pushtetarët nuk e panë asnjë herë të nevojshme e të arsyeshme që të bëhej ndonjë investim, që do të rregullonte mirëqenien e këtyre banorëve, në të kundërtën pasuria e madhe e kësaj treve shfrytëzohej pa mëshirë dhe shkonte në parktim. Fabrika e drurit punohej m'u në mes të qytetit, rrugët që duhej të lidhnin shtetet dhe të kalonin nëpër këtë zonë, anashkaloheshin në të tjera drejtime, derisa kjo rrugë mbetej vështirë e kalueshme dhe e

t'i zhdukë askush, mbijetuan bukuritë mahnitëse të Rugovës, tradita dhe vlerat e mëdha shpirtërore e kulturore të këtyre malësorëve. Dhe tani mendojmë se edhe kjo trevë duhet të ketë një vizion të qartë për të ardhmen e vet. Për këtë nuk duhet të ketë mëdysheje, nga askush, as frikë, por duhen mbështetur e përkrahur të gjithë ata që kanë vizion të qartë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe për ruajtjen e kultivimin e këtyre vlerave. Është koha kur duhet ta ruajmë e kultivojmë këtë pasuri edhe pse kërkesat pas luftës ishin tejet të mëdha për prerjen e pyjeve. Pikërisht për të ruajtur këtë pasuri të madhe e për ta menaxhuar drejt atë punon e përpiqet Shoqata e familjeve pronarë të pyjeve private, e cila është krijuar qysh në vitin 2010 me mbështetje të SNV. Shoqata punon për të përmirësuar gjendjen e pyjeve, duke u nisur që nga rekomandimet që kemi propozua të hyjnë në ligjin e ri të pyjeve, çështjen e kontesteve, si dhe aktivitete tjera, që kanë të bëjnë me fuqizimin e zhvillimit të qëndrueshëm të pyjeve në Rugovë, Pejë e gjithë Kosovën.

Mendojmë se në trevën e Rugovës, me këto vlera të shumta, ofrohen edhe mundësi të shumta zhvillimi, siç janë turizmi, sidomos ai malor, si dhe qendra skish, blegtori, mbledhje e kultivim frutash

malore, bletari, gjueti, ndërtim qendrash të ndryshme shëruese e rehabilituese, zhvillimi i artizanateve të vjetra, karakteristike për këtë treve, përpunimi i ushqimit natyral ekologjik, i cili dita-ditës do të jetë më i kërkuar, pastaj edhe industria e drurit dhe drejtime tjera zhvillimi. Por, mbi të gjitha, janë bukuritë e rralla natyrore, sidomos pushtimi i bjeshkëve të larta, ku mendojmë se fshihen bukuritë mahnitëse të kësaj treve. Për këtë nevojitet zhvillimi i hovshëm i turizmit e i blegtorisë, si dhe ruajtja e pyjeve. Rugova siç është sot nuk ofron mundësi të mëdha mirëqenieje për banorët e saj, përkundër pasurive të mëdha që ka. Por, nuk na duhet Rugova e zbrazur nga banorët. Duhet mbledhur në radhe të parë të gjitha forcat intelektuale, politike e sidomos të rinjtë, të bëjmë diçka. Rugovës i duhen kthyer banorët, nxënësit e shkollave, duhet kthyer blegërima e deleve, duhen sjellë vizitorë, jo vetëm nga Kosova e rajoni, por edhe nga mbarë bota, sepse kemi çfarë t'u ofrojmë. Prandaj, duhen iniciativa, duhen plane e projekte, duhet hapja dhe bashkëpunimi. Rugova ka të ardhme të mirë. Edhe Rugova, sikurse gjithë Kosova e Re, më në fund e kanë gjetur vendin e vet, aty ku e kishin me shekuj, në Evropën e Bashkuar, në botën e qytetëruar ...

## Me kujdesin e komunitetit pyjet do të marrin zhvillim të qëndrueshëm

Intervistë e Ahmet MEHMETIT, inxhinier në Ndërmarrjen Pyjore Elbasan

Vijon nga fq. 1

**Përse është i rëndësishëm kalimi i pyjeve shtetërorë në komunalë, pra në pronësi të qeverisjes vendore?**

Një nga vendimet e rëndësishme të qeverisë është dhe kalimi i pyjeve nga shtetërorë në komunalë, në pronësi të qeverisjes vendore dhe komunitetit, gjë që do të ndihmojë për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve. Ky vendim e bën komunitetin më të interesuar dhe e afron më afër pyllit. Në këtë mënyrë komuniteti i del për zot kësaj pasurie, siç janë pyjet, kullotat dhe burimet natyrore. Ky vendim është pritur mirë nga komuniteti, sepse ai ka qenë i lidhur me pyjet në të kaluarën, është kujdesur për ta dhe ka bërë që ata të zhvillohen në shekuj. Duke u kujdesur komuniteti pyjet do të marrin zhvillim dhe qëndrueshmëri më të madhe.

**Konkretisht, ku jemi tani, në cilën fazë, dhe si po vepron?**

Konkretisht, sot pyjet duhet të kalojnë nga shteti që i ka aktualisht te komuniteti, që është më afër dhe

më i interesuar për ta. Duhet që të gjitha ndërmarrjet e pyjeve dhe kullotave ta bëjnë kalimin e këtyre sipërfaqeve sa më shpejt. Për këtë, janë ngritur grupet e punës nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor dhe pushtetit vendor. Megjithatë, ka probleme në ndarjen e vijës kufitare midis fshatrave e komunave. Në bazë të ligjit janë ngritur dhe funksionojnë njësitë e menaxhimit të pyjeve, të cilat kanë në përbërje specialistë, të cilët, sipas ligjit, duhet të jenë inxhinierë pyjesh dhe teknikë. Studimi vazhdon. Në Elbasan, në katër komuna, janë ngritur zyrat për këtë qëllim. Librazhdi dhe Gramshi kanë përparuar në këtë drejtim, po sidomos Librazhdi, i cili ka sipërfaqen më të madhe të pyjeve.

**A ka probleme me kufijtë administrativë midis fshatrave?**

Duhet që komunat shumë shpejt të përcaktojnë kufijtë administrativë të tyre, sepse krijohen probleme për dhënien në pronësi ose në përdorim. Një nga ndihmat është dhe "telefonja e gjelbër", ku nga një program i IPA-s jepen dhe ndihma në specialistë e asistencë për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve. Kërkohet që të ngrihen sa më parë njësitë e menaxhimit të pyjeve, sepse do t'i shërbejnë sa më mirë zhvillimit të qëndrueshëm të pyjeve. Librazhdi, duke pasur disa zona të mbrojtura dhe Parkun Kombëtar Shebenik - Jablanicë, ka potencial të madh pyjor. Duke pasur një nga parqet me të rëndësishme të vendit, Librazhdi merr drejtim eko-turistik, floristik e faunistik. Madje

dhe festa e organizuar nga Qarku i Elbasanit për hapjen e turizmit malor në Parkun Kombëtar të Shebenikut, flet edhe për resurset rekreative të kësaj zone.

**Sa ndikon rikthimi në traditën e mbrojtjes së këtyre pyjeve?**

Rikthimi në traditë, duke njohur apo rivendosur kufijtë nga pleqësitë (kryesitë) e fshatrave, pa ndërhyrjen e organeve shtetërore, pati ndikim pozitiv, pasi megjithëse të degraduara e me prodhimtari të ulët, filluan të vihen nën kontroll, për të ndaluar prerjet dhe kullotjen pa kriter, për të mundësuar ripërtëritjen e tyre. Këtë përmirësim të pyjeve mund ta shohim dukshëm pothuaj në të gjitha pyjet afër fshatrave e komunave të qarkut të Elbasanit, ku ka filluar ky proces. Përmendim dhe mbrojtjen e pyjeve nga komuniteti i Stëblevës në Librazhd, ku shumë herë janë bërë dhe protesta të fuqishme për shfrytëzimin barbar të pyjeve.

**Kur ka filluar reforma e pyjeve?**

Që nga viti 1996 në vendin tonë ka filluar një "reformë" për pyjet e kullotat, duke u mbështetur tek ligji përkatës dhe disa akte nënligjore. Mbështetje të madhe ka dhënë Projekti Shqiptar i Pyjeve (i Bankës Botërore), duke filluar kalimin e pyjeve dhe kullotave në përdorim të komuniteteve lokale. I vlerësuar si një nga komponentët kryesorë e me të arrirë të Projektit,

Vijon në fq. 5

**K**osova ka mjaft resurse cilësore turistike. Ato ofrojnë mundësinë e turizmit dimëror dhe malor, atij rekreativo-sportiv, turizmit kulturor të bazuar në trashëgiminë e bollshme historiko-kulturore. Studimet e deritanishme, tregojnë se në Rajonin e Alpeve Shqiptare dhe Bjeshkëve të Namuna ka kushte për zhvillimin e turizmit me ngritjen e shumë qendrave turistike, siç është kompleksi turistik-hotelierik i Skitarisë në Brezovic të Sharrit etj. Kosova është e njohur edhe me atraksione të tjera turistike, siç janë: Gryka e Rugovës, Gryka e Kaçanikut, Shpella e Gadimes, Ujëvara e Mirushes, Burimi i Drinit të Bardhë, mjaft banja termale, si Banjat e Pejës dhe Klokotit, ekzemplarë trashëgimie kulturore, etj. Me këto vlera të jashtëzakonshme, turizmi dhe ekonomia në Kosovë do të mund të zhvillohen edhe më shumë me një qasje më të përkushtuar. Kosova duhet avancuar në zhvillimin e turizmit, duke shkëmbyer kështu eksperiencat edhe me vendet e Rajonit. Viset malore të Kosovës paraqesin bukuri natyrore, që mund të krahasohen me ato më të bukurat e Evropës. Prandaj, duhet bërë prezantim më cilësor, në mënyrë që të ketë informacion të mjaftë për këtë fushë. Kjo mund të realizohet përmes teknologjisë informative, si interneti, website, spote publicitare, përmes medieëve, etj.

Duke u ndërlidhur me këtë, zhvillimi i teknologjive të informacionit është shumë i rëndësishëm për çka edhe ka filluar me formimin e rrjeteve sociale, sidomos me fermerët e fshatrave. Hulumtimet tregojnë se rrjetet sociale veprojnë nga niveli i familjes e deri te niveli kombëtar dhe luajnë rol vendimtar në përcaktimin e zgjidhjes së problemeve, si dhe në shkallën kur një individ do të ketë sukses në arritjen e që-

# Kosova ofron mundësi për zhvillimin e turizmit rural

nga Ardita DINAJ



llimeve të tij. Rrjetet sociale, që po formohen përmes shoqatave turistike, siç është edhe "Rugova Eksperiencë" nga Peja, tregojnë se përkundër atraksioneve dhe kushteve për zhvillimin e turizmit ende ekziston një arsye e ngecjes në këtë proces. Kjo është migrimi i fshatrave, që po ndodh çdo ditë e më tepër. Prandaj Shteti i Kosovës duhet të ketë një qasje sistematike dhe strategji të qartë për të zgjidhur problemin e prapambetjes ekonomike, si arsyeja kryesore e migrimit. Duhet të krijohen kushte për ardhjen e investitorëve në zonat rurale. Prandaj, zhvillimi

i turizmit malor mund të kontribuojë në zgjidhjen e këtij problemi.

Në Kosovë ka burime natyrore të jashtëzakonshme, për t'u marrë me këtë veprimtari, që do të duhej të ofroje ekoturizëm, gjueti dhe peshkim, gastronomi tradicionale, produkte vendase, etj. Prandaj, për një zhvillim më të hovshëm të turizmit, prioritetet u është dhënë zonave rurale dhe, në këtë vështrim, duhen ndërmarrë masa për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale. Mbi 40 % e popullsisë jeton në zonat rurale, kështu që nuk ka asnjë shans serioz zhvillimi nëse ata

nuk kanë përmirësuar arsimimin e popullatës rurale. Duke u nisur nga niveli qendror e deri tek ai lokal, duhet kryesisht të përqendrohen në ngritjen e nivelit arsimor në mënyrë që të sigurojnë kushte të barabarta për përmirësimin e njohurive dhe aftësive në fushën e informacionit, çka çon në zhvillimin e zonave të pazhvilluara. Degradimi i kulturës në zonat rurale, standardi i ulët i jetesës, çojnë në migrimin e mëtejshëm të popullatës nga fshati në qytet. Strategjia e Republikës së Kosovës përcakton turizmin rural si një sërë aktiviteteve të shërbimeve dhe objekteve të tjera, që duhet të organizohen nga popullsia rurale.

Në mënyrë që të tërhiqen shumë turistë dhe të krijohen të hyra shtesë duhet të zhvillohen feramat familjare. Kjo u ofron turistëve elementet e fshatit, të natyrës dhe paraqesin mikpritjen tradicionale dhe vlerat mjedisore të popullatës lokale dhe, si i tillë, është një hap zhvillimi ekonomik në ngritjen e standardeve të jetesës në komunitetet rurale. Me interes të veçantë janë format e kombinuara të turizmit, si ekoturizmi, turizmi kulturor, vilat, feramat, aktiviteteve në natyrë,



etj., mbështetur në përvojën rurale të Kosovës (veçanërisht në zonat e rrafshit të Dukagjinit).

Ndryshimet që kanë përfshirë zonat rurale do të ndikojnë në ndryshimin brenda familjeve, ku zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme të turizmit rural, shumë banorë të zonave rurale do t'i sillte në pozitë të përshtatur për mbijetesë. Me zhvillimin dhe modernizimin e familjeve rurale do të krijohen kushte për zhvillimin e fshatrave e vendbanimeve rurale dhe turizmin rural. Duhet të theksohet se tani vetëm me zhvillimin e turizmit rural, migrimi nga fshati në qytet mund të ndalet. Zhvillimi i Turizmit është i rëndësishëm sepse është i lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit bujqësor. Tani për tani, familjet rurale të angazhuara në fushën e turizmit mund të strehojnë një numër të vogël turistësh, kryesisht në shtëpi. Është ende një numër i vogël familjesh që mund të strehojnë më shumë turistë, përveç disave që kanë objekte hoteliere në zonat rurale. Pra, turizmi rural është duke u bërë një tregues gjithnjë e më tërheqës e i besueshëm për zbatim të konceptit të bujqësisë shumëfunktionale në Kosovë.

## Vijon nga fq. 4

në komunat ku ka filluar, ky proces është mjaft efikas. Mbi të gjitha, vlerësohet përkujdesja e përdoruesve, tashmë rrallë ka prerje të pakontrolluara. Nga këto pyje nuk lejohet të nxirren për shitje sasi lënde e dru zjarri si më parë.

### Si është vepruar për kufirin tradicional midis fshatrave ose dhe komunave?

E rëndësishme është të theksohet se në përgjithësi është gjetur mirëkuptim kur është shkuar te kufiri tradicional, palët nuk kanë pasur mosmarrëveshje, procesverbalet e mbajtura në vend janë firmosur nga të gjithë anëtarët e komisioneve. Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në rrethe kanë punuar mirë, kryetarët e atyre fshatrave (komisionet e pyjeve dhe kullotave), që janë këshilluar me të moshuar gjatë procesit të ndarjes së kufijve të pyjeve e kullotave midis fshatrave apo edhe brenda fshatit, kane arritur të bëjnë ndarje që komuniteti i ka pranuar, përmes plotësimit të dokumentacionit përkatës, duke i futur pyjet e kullotat komunale në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Ka akoma problem saktësimi i kufijve midis fshatrave. Një ndihmesë e madhe është edhe "telefonja e gjelbër", ku ne japim edhe këshillime për të gjitha rastet dhe kërkesat. Sa më shpejt që të bëhet kalimi në pronësi të qeverisjes vendore aq më shpejt dhe aq më shumë do të kemi pyje të mbrojtura.

## Drurë mjaltëdhënës të Kosovës

Flora mjaltëdhënëse në Kosovë është e shumtë. Prej drurëve mjaltëdhënës, më të rëndësishëm janë:

### Gështenja e butë (*Castanea sativa M.*)

Është përhapur në rajonin e Pejës, të Deçanit dhe të Gjakovës, ku gjenden afro 2000 ha male.

Është kullotë mesa-tare e nganjëherë e forte, që lulëzon rreth 20 qershorit, kur dhe jep sasi të mëdha nektari. Kur lulëzon në fund të qershorit, jep sasi të pakta nektari, sepse nga vapa e madhe thahet lehtë nektari. Bletët e vizitojnë me qejf sepse marrin sasi të mëdha pjalmi, i cili asnjë-



herë nuk dështon. Mjalti i gështenjes ka ngjyrë të verdhë në të mbyllur, me aromë shumë të fortë, si të vetë bimës. Shijen e ka të ëmbël në të hidhët dhe të djeg në fyt, çka e bën pak të preferueshëm nga mjaft njerëz.

### Bliri (*Tilia sp.*)

Sipërfaqet më të mëdha me këtë bimë gjenden në Lipovicë, në Radafc te burimi i Drinit të Bardhë, në grykë të Lloçanit (Deçan) etj. Në Pejë, Prishtinë, Viti, etj., gjendet në lulishte e në rrugë. Lulëzon gjatë qershorit (nga 10 qershori) dhe ka cikël lulëzimi 20-25 ditë. Sekretin pak nektar, prandaj dhe bletët



duke e vizituar shpesh dobësohen. Mjalti është i verdhë në të gjelbër. Ka erë të fortë në lule, me shije dhe aromë të këndshme.

### Bagreni ose akacia (*Robinia pseudoacacia*)

Zë vendin e parë si kullotë për bletët dhe rritet në toka të dobëta. E gjejmë më tepër në zonën e bjeshkëve të Sharrit, si në Shtërpçë, Mushiçë, në Radafc, Vitomirë, në Lug të Leshanit, Lug të Baranit, në rrethinat e Deçanit, Krushë të madhe, Mamushë, Landovicë, etj. Lulëzon nga 10 maji, kur familjet bletë shpesh nuk janë të fuqizuar sa duhet, prandaj mund të themi që nuk shfrytëzohet plotësisht.



Lulëzimi vazhdon 12-18 ditë. Në kushte të volitshme familjet e forta me bletë për 10 ditë prodhojnë deri 50 kg mjaltë. Mjalti është i shndritshëm, i tejdukshëm, gati pa ngjyrë, ndërsa shijen e ka si të luleve të akacies. Nuk kristalizohet edhe për një vit se përmban sasi më të madhe fruktoze se sa glukoze, por në se ruhet në vende jo të ftohta e me lagështi.

### Thana (*Cornus mas*)

Është bimë mjaltëdhënëse që lulëzon herët. Është përhapur në të gjithë Kosovën nëpër mezhda e gardhe. Në rrëzë të Bjeshkëve të Namuna dhe të Sharrit e gjejmë në sasi më të madhe. Lulëzon nga mesi i marsit dhe nuk shfrytëzohet mirë nga bletët sepse koha në të shumtën e rasteve është e ftohtë.



# Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të NjQV-ve PROBLEM I VËSHTIRË APO I NEGLIZHUAR?

Gjon FIERZA, Specialist për pyjet në DSHP, Tiranë - Janaq MALE, Specialist për pyjet në SNV, Tiranë

## Vijon nga fq. 1

nga një sërë problemesh, duke përfshirë edhe saktësinë e kufijve ekzistues të regjistruar (për fshatrat dhe komunat), regjistrimin fillestar të tokave bujqësore, zgjidhjen e konflikteve lokale për kufijtë, mungesën e ndërjegjësimit/informimit, kapacitetet e kufizuara, moskuptimin e rëndësisë së procesit dhe neglizhencën nga shumë NjQV. Edhe pse regjistrimi i pronave është proces specifik dhe shumë teknik, është e domosdoshme që të merren disa vendime politike për të mbështetur përfundimin e procesit në mënyrë efektive.

SNV ka ndërmarrë një konsulencë përmes projektit për fuqizimin e qëndrueshëm të pylltarisë komunale, për të bërë investigimin e situatës aktuale të procesit të regjistrimit të pyjeve e kullotave komunale dhe të rishikojë sistemin përkatës të regjistrimit, bazuar në kuadrin ligjor aktual dhe eksperiencën në regjistrimin e tokës bujqësore. Rekomandimet që do të jepen do të përmirësojnë procesin dhe nivelin e regjistrimit, duke u siguruar komunave dhe aktorëve të tjerë lokalë informacion të vlefshëm për të filluar e përfunduar procesin e regjistrimit.

## Çështje kryesore të transferimit dhe regjistrimit të pyjeve e kullotave komunale

Procesi i transferimit dhe i regjistrimit të pyjeve e kullotave si pasuri të paluajtshme të NJQV dhe përdoruesit e tyre, është kompleks. Kjo do të thotë se marrja e një vendimi nga Këshilli i Ministrave për transferimin e pyjeve dhe kullotave në komuna apo bashki, mund të konsiderohet si hapi i fillimit në menaxhimin afatgjatë të këtyre burimeve në mënyrë të qëndrueshme. Prandaj, suksesi në realizimin e këtij procesi varet, së pari, nga NjQV dhe, së dyti, nga përdoruesit tradicionalë të pyjeve e kullotave. Transferimi i pyjeve në pronësi të NjQV, është realizuar masivisht me VKM në vitin 2008 dhe rreth 300 NJQV (komuna e bashki) kanë marrë në pronësi mbi 50 % të fondit pyjor/kullosor kombëtar. Sfidat e tanishme është që pronarët e rinj (komunat e bashkitë) mbas regjistrimit të këtyre pronave, ta shtrijnë këtë proces edhe në fshatrat dhe familjet, duke transferuar të drejtën e përdorimit. Kalimi i pyjeve/kullotave tek njësitë e qeverisjes vendore është proces që ka si objekt kryesor transferimin real të kompetencave, pra të drejtave e përgjegjësisë, nga shteti (Shërbimi Pyjor) tek qeverisja vendore (komuna/ bashki), duke përfshirë gjerësisht komunitetin lokal në mbarëshkrimin e qëndrueshëm të tyre. Banorët vendorë duhet t'i mbrojnë dhe të marrin më shumë shërbime nga pyjet e kullotat, të mbrohet mjedisi, por edhe të rritet niveli i jetesës në fshat, si pasojë e prodhimeve që merren nga këto burime.

Deri në fund të vitit 2011 (që ishte periudha e këtij raporti) numri i njësitë të qeverisjes vendore (NJQV) që kanë filluar e përfunduar regjistrimin e pyjeve dhe kullotave që kanë marrë në pronësi, ishte i papërfillshëm. Këto janë kryesisht çështje të mungesës së informacionit, kapaciteteve njerëzore, financiare e logjistike, të mosnjohjes së procesit dhe udhëzuesit teknik përkatës "Për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave". Ky proces nuk është vlerësuar si prioritet nga NjQV, nuk ka pasur përpjekje për të siguruar financime për këtë proces, etj. Regjistrimi i pronave të paluajtshme është proces i specializuar dhe teknik në përgjithësi, për pyjet e kullotat ai duhet mbështetur detyrimisht me disa vendime politike të nevojshme për fillimin dhe përfundimin e procesit sa më shpejt dhe në mënyrë cilësore.

1. Sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të NjQV, të cilat më parë kanë qenë në pronësi dhe menaxhuar nga shteti, kur nuk kanë qenë dhe nuk janë regjistruar në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (SRPP). Pra, nuk kanë gjetur zbatim praktikisht dy ligje të rëndësishme: Ligji Nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar; Ligji Nr. 9385, datë 4.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar.

2. Procesi për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave në SRPP është pothuaj i panjohur nga shumica e NjQV, si dhe nga Shërbimi Pyjor në nivel DSHP. Pak njihet Udhëzuesi "Për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave, i viti 1999, nga Shërbimi Pyjor, por dhe nga punonjësit e Zyrave vendore të regjistrimit të pasurive (ZVRP) në rrethe.

3. Asnjë komunë ose bashki (NjQV) nuk ka regjistruar në ZVRPP sipërfaqet pyjore ose kullotat të transferuara në pronësi/përdorim sipas VKM të vitit 2008. Ndonjë komunë në Gjirokastrë, Korçë, Tiranë, etj., ka regjistruar sipërfaqe të kufizuara të fondit pyjor, vetëm sipërfaqe ku janë instaluar antenat për telefoni celularë. Këto janë regjistruar për të

formalizuar marrëdhëniet kontraktuale midis NJQV dhe përdoruesit (subjekte private).

4. Burimet financiare, logjistike e njerëzore të kufizuara në shumicës e njësitë të qeverisjes vendore, e bëjnë thuajse të pamundur përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm teknik për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave nga vetë NJQV. Thuajse për të gjitha NjQV, përgatitja e hartave të zonave kadastrale për SRPP, ku të përfshihen dhe pyjet e kullotat, paraqet vështirësi teknike.

5. Cilësia dhe saktësia e informacionit për ngastrat pyjore/kullosore të transferuara në pronësi të NJQV, ndryshon shumë, krahasuar me gjendjen në terren. Ka ndryshime në sipërfaqe e destinacion, në përdorimin e tokës pyjore, në kufirin fizik, etj. Të dhënat e marra nga inventarët e pyjeve, kryesisht të vitit 1985 (informacion tashmë i tejkaluar në afat kohor) i pa përditësuar rregullisht, nuk përfaqëson gjendjen e tanishme në shumë tregues kadastralë të fondit pyjor e kullosor. Kjo evidenton saktësinë e pamjaftueshme të kadastrës pyjore e kullosore (kombëtare) pamundësinë e reflektimit të shpejtë të këtyre ndryshimeve. Është një mundësi e kufizuar përdorimi i informacionit që jep kadastra pyjore dhe hartat përkatëse për futjen në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (SRPP) të pyjeve e kullotave, jo vetëm të atyre komunale, por në tërësi të fondit pyjor/kullosor kombëtar.

6. Shumë kryetarë e përfaqësues të komunave, në disa seminare të zhvilluar në qarqe apo dhe kontakte të tjera, kërkojnë dhe argumentojnë se procesi i transferimit të pyjeve e kullotave, listat përkatëse të ngastrave pyjore, duhet të rishikohen. Në shumë raste NJQV shprehin se listat e inventarit të ngastrave pyjore nuk kanë mundur t'i përgatisin vetë, por kanë pranuar ato lista që u ka ofruar Shërbimi Pyjor. Sipërfaqet e transferuara nuk plotësojnë nevojat e komunitetit përkatës dhe nuk kanë shtrirjen e tyre tradicionale. Kjo tregon nevojën për përmirësime të ndjeshme në procesin e inventarizimit dhe transferimit. Kanë munguar konsultime me banorët lokalë, kryetarët e fshatrave dhe komunave kufitare, të cilët janë aktorët kryesorë që kanë edhe përgjegjësinë për saktësimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore që ndahen midis tyre.

7. Regjistrimi i ngastrave pyjore dhe kullotave varet edhe nga regjistrimi fillestar ekzistues i pasurive të paluajtshme, kryesisht nga saktësia e regjistrimit fillestar të tokës bujqësore dhe ndarja e kufijve të zonave kadastrale (ZK-fshatrave). Kufijtë dhe sipërfaqja e ZK, tashmë saktësohet pasi të përfshihet edhe fondi pyjor/kullosor i kaluar në pronësi. Nga NJQV përveç saktësimin përfundimtar të kufijve të pyjeve e kullotave midis tyre, kërkohet edhe saktësimi i kufijve të fshatrave në përbërje të tyre, për të përmbushur kërkesat e sistemit të regjistrimit dhe numërimit unik të pasurive të paluajtshme. Në qarkun e Kukësit, disa komuna pretendojnë se vazhdohet të njihen ata kufij të ndarjes administrative të ish-kooperativave bujqësore, pra të para viteve 1990, ndërkohë që situata dhe ndarja administrative është dhe duhet të jetë ndryshe. Mungesa e saktësimin të kufijve të fshatrave dhe komunave në terren dhe në harta (ku pas tokës bujqësore e pasurive të tjera të paluajtshme të regjistruar) të vazhdohet me regjistrimin fillestar të pyjeve e kullotave, del si problem i madh, që pengon praktikisht regjistrimin e tyre.

8. Me kalimin në pronësi të pyjeve e kullotave, për NJQV shtohen përgjegjësi të reja për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve natyrore. Në shumë NJQV, ka mungese stafi të kualifikuar profesional pyjor. Ky staf duhet të kryejë në mënyrë profesionale administrimin dhe zbatimin e planit të menaxhimit të pyjeve e kullotave të komunës. Ai duhet të përgatisë të gjitha planet e tjera të zhvillimit, afatshkurtra e afatmesme, për fondin pyjor e kullosor në nivel komune, në përputhje me planin kombëtar.

9. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme është detyrim ligjor i pronarit të tyre, këtu janë të përfshira pyjet dhe kullotat e transferuara tek NJQV, por vihet re se ka mungesë vullneti nga drejtuesit vendorë, për të kërkuar mbështetje, për të komunikuar me ZVRPP, për të njohur e filluar procesin e regjistrimit të pyjeve e kullotave. Me VKM u bë heqja e tarifave të regjistrimit të pyjeve e kullotave, si masë lehtësuese, janë hequr dënimet për regjistrimin e vonuar, përsëri procesi nuk po fillon. Në mungesë të një regjistrimi fillestar të pyjeve/kullotave si ish-pronë shtetërore, tashmë procesi nuk mund të zvarritet. Çështja e regjistrimit është në dorë të pronarit të ri. Mungesa e përgjegjësisë dhe administrimit në disa fusha të rëndësishme, përfshi dhe pyjet, ka krijuar kushte për abuzim dhe degradim

mjedisor. Kjo duhet të trajtohet si çështje kombëtare, prandaj duhen marrë masa për të zgjidhur këtë problem urgjentisht.

10. Ka interpretime të ndryshme nga kryetarët dhe stafi teknik në disa komuna, lidhur me përgjegjësitë e tyre për administrimin e fondit pyjor/kullosor të transferuar nga shteti në NJQV. Kjo është theksuar nga komunat, në rastin e mbledhjes së taksave dhe tarifave, siç kërkohet nga VKM nr. 22, datë 09.01.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal". Disa nuk duan ta njohin pronësinë e pyjeve, për këtë arsye përgjegjësia për administrimin e të ardhurave, menaxhimin e tyre, dhënia me kontratë përdoruesit tradicional, etj., janë procese që duhet të fillojnë pasi të bëhet regjistrimi fillestar i tyre si pasuri e paluajtshme e transferuar në NJQV.

## Çështje teknike gjatë procesit të regjistrimit

1. Procesi i regjistrimit kërkon kufij të dixhitalizuar të çdo fshati (ZK) dhe në këtë mënyrë të çdo komune. Që në vitin 1994 e deri në ditët e sotme është bërë shumë punë dhe përpjekje për të përfunduar regjistrimin fillestar të tokës bujqësore dhe pasurive të tjera urbane. Është përfunduar regjistrimi fillestar në shumicën zonave kadastrale (fshati - ZK) të vendit dhe tashmë ato pasuri janë futur në SRPP. Megjithatë, për vështirësitë dhe problematiken që ka pasur ky proces, nuk mund të themi se ka përfunduar regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme (tokë bujqësore) në vend. Për fat të keq pyjet/kullotat nuk janë përfshirë në këtë proces regjistrimi fillestar, ato nuk janë konsideruar të regjistruara si pasuri në vijueshmëri të pasurive të tjera në një ZK.

2. Regjistrimi fillestar i tokës bujqësore është mbështetur tek dokumentacioni i ndarjes së tokës, lëshuar nga NJQV, të cilat drejtpërdrejt nuk janë përfshirë në këtë proces. Banorët vendorë kanë vendosur komunikim të drejtpërdrejtë me subjektet private regjistruese në procesin e regjistrimit fillestar. Për pyjet e kullotat nuk ka ekzistuar interes i drejtpërdrejtë nga pushteti i NJQV dhe kryetarët e fshatrave, për të bërë regjistrimin e tyre. Edhe në të ardhmen, me këto mekanizma rregullatorë në fuqi, duket se për pyjet e kullotat procesi i regjistrimit do jetë i vështirë, për veçse për shumë aspekteve teknike, ai nuk do vlerësohet sa duhet.

3. Informacioni hartografik i përdorur në vite nga Shërbimi Pyjor, pra dhe në rastin e transferimit të pyjeve/kullotave në komuna, përbëhet nga harta skematike të dizenuara me dorë, duke mos garantuar saktësi, të fotokopjuara disa herë, që shërbejnë vetëm për identifikimin e numrit të parcelave pyjore/kullosore. Ato përbëjnë problem për t'u përdorur në caktimin e sipërfaqeve pyjore, për shkak të cilësisë së dobët.

4. Inventarët e pyjeve dhe kullotave, të hartuar në vitet 2002-2004 nga DSHP dhe NJQV e të dërguar në AITPP në Ministrinë e Brendshme, në përgjithësi kanë shumë pasaktësi. Pra, kanë dalë lista të pyjeve/ kullotave të pasakta, mbi bazën e të cilave është bërë VKM për çdo komunë. Kjo përbën një tjetër vështirësi për procesin e regjistrimit. Sipas ZRPP çdo ndryshim në listat e inventarit kërkon një vendim të ri nga KM. Pra, për shumë NJQV, inventarët duhet të përmirësohen, gjë që do të thotë që shumë VKM duhet të ndryshohen sipas listave të përmirësuar.

5. Rreth 250 NJQV, kanë plane menaxhimi për pyjet dhe kullotat në pronësi, të miratuara në këshillat vendore përkatëse, ku përveç përshkrimit teknik të pyllit/kullotës, ka dhe aspekte të tjera sociale-ekonomike, administrative, të fshatrave dhe komunës në tërësi. Cilësia e këtyre planeve është e ndryshme, si rregull në to janë identifikuar edhe përdoruesit e çdo fshati me listat përkatëse. Në shumë plane të menaxhimit të NJQV, përdorimi i ngastrave pyjore/kullosore, është i grupuar me përdorues, si fshat, pak ka identifikime si lagje apo grup familjesh dhe më pak me lista përdoruesish si familje. Në tërësi mund të themi se jo sa dhe si duhet është punuar edhe me këto plane për të evidentuar përdoruesit tradicionalë dhe ndarjet e kufijve midis fshatrave.

6. Planet e menaxhimit, të miratuara në këshillat e NJQV, kanë si pjesë të tyre edhe listat e përdoruesve të pyjeve e kullotave komunale. Identifikimi i tyre është bërë gjatë hartimit të planeve në nivel fshati me pjesëmarrje. Edhe pse pyjet e kullotat, me VKM kaluan në pronësi të NJQV, ato nuk kanë vijuar më tej me procedurat e dhënies në përdorim të sipërfaqeve pyjore/kullosore përdoruesve tradicionalë. Por kjo është çështja kyç në gjithë procesin e decentralizimit dhe tregon se nuk është realizuar një ndër hapat kryesorë të procesit të transferimit të pyjeve/kullotave. Komunitetet vendore, nëpërmjet zërit të Federatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale (FKPKK) kanë lobuar e kërkuar që këto sipërfaqe të fondit pyjor të privatizohen drejtpërdrejt, sipas formës tradicionale të përdorimit.

7. Hartat që janë përdorur nga Shërbimi Pyjor, kryesisht 1:25000 e rrallë 1:10000, jo të dixhitalizura, përbejnë një problematikë të gjerë e komplekse, me shumë gabime. Këto harta e të dhëna janë bashkëngjitur në çdo VKM për transferimin në vitin 2008. Çdo gabim ose pasaktësi rritet kur këto harta transferohen në shkallën 1:2500.

Po ashtu, shumë çështje të tjera lindin në lidhje me mos-përputhjen me pronat e tjera, kufijtë, madhësia e sipërfaqes në listë e në realitet, etj. Këto lidhen me aspektet teknike e ligjore, që duhen trajtuar e zgjidhur nëpërmjet amendamenteve të reja teknike e ligjore.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Tradita vazhdon

Në Bjeshkët e Kukësit

nga Ilmi GJANA

# Jeta në stane gjatë verës

Me daljen e pranverës si në fshat edhe në bjeshkë ka qenë traditë një farë rregulli, që s'kishte të drejtë askush ta ndryshonte, pavarësisht se i pëlqente ose jo dikujt. Me 6 maj, siç e quan populli, Dita e Shëngjergjit, bëheshin disa ceremoni domethënëse. Që në mëngjes herët të gjithë banorët zgjoheshin dhe shkonin e merrnin degë druri të njomë dhe i ngulnin në të gjitha objektet që kishin të bënin me pronën, si në arë, livadh e zabel, por edhe në kopshtije. Me këtë nënkuptohej se kjo pronë ka të zot. Kështu veprohej edhe në Bjeshkë. Secili ngulte një degë druri të njomë për simbolikë. Kështu edhe pas kësaj dite, kur dikush e shikonte këtë degë të njomë, të ngulur në livadh apo arë, nuk kishte të drejtë të kulloste bagëtitë në atë pjesë, sepse ishte i ndërgjegjshëm se do të bënte dëm, pasi ajo është me zot. Në bjeshkë dilnin ato familje që kishin të drejtë për të dalë në një vend të caktuar e të organizuar në shkallë fisi po rrallë edhe si familje. Bjeshka ose Kullota për kullotje shprehej me një njësi matëse të veçantë (në numër krerësh), psh 500 dhen dhe vendi ku kullosohnin këto krerë, kurse kullota për kositje shprehej me kosa, dmth aq punëtorë në ditë sa mund të punonin gjatë këtij procesi.

Edhe sot, në ditët tona, njerëzit në bjeshkë dalin të grupuar, siç i thoshin me Ortaki, sepse shpenzimet ishin më të vogla dhe mënyra e organizimit më efikase. Fermerët i rregullonin ndërtesat ose stanet në mënyrë që të mos zinin vendin e bagëtive, vendin e kopshtijeve, por vendoseshin në kofrë ose vend ku nuk pengohej askush. Në stane ishte vendi i caktuar për kullotë dhe për kositje. Gjatë kullotës nuk kishte të drejtë askush të dëmtonte edhe një pëllëmbë kullotë për kositje me tufat e tij, ndryshe, atë që dëmtonte, e priste dënimi sipas vendimit që merrej në fshat. Edhe burimet e ujit ishin me vendime të prera se si të mbushesh ujë për shërbime familjare dhe për nevojat e bagëtive (për pirje). Në një burim uji ndërtohen lugje prej druri ose betoni, në formë koritash, sëgjati. Në këto lugje tufat pinë ujë me radhë. Në fillim kecat e qengjat, pastaj dhitë e dhentë dhe në fund të trashat, lopët e qetë e zgjedhës dhe kuajt, por edhe kjo radhe me një orar të caktuar, gjithmonë pas orës 09<sup>30</sup>, sepse para kësaj ore mbushin ujë të gjithë njerëzit që janë në atë territor për shërbime. Sipas rregullit, gjatë radhës për bagëtinë, kur një tufë është duke pirë, tufa tjetër pret afër burimit, në mriz, nëse ka aty pranë, kurse tufa tjetër pi ujë dhe vazhdon rrugën në drejtimin nga ka vathën. Ka rregull edhe për larjen e pas-trimin e rrobave. Një bjeshkatarrë e grua që jeton në stan gjatë verës, në stanet e zakonshëm) që bën këtë aktivitet, ka të drejtë për të pastruar dhe për të venë kusinë apo kazanin e valës 30 m larg burimit, në mënyrë që të mos ndikojë te bagëtitë (sepse bie uji me detergjent në lugje). Të drejtën për të mbushur kusinë me ujë ajo e ka vetëm në koritën e fundit të lugut.

Në zonat tona gjithmonë në bjeshkët verore, ka pasur dhe ruhet edhe sot një rregull për mrizet për të mrizuar (mërxyer) të imëtat gjatë pushimit në dreke, sepse s'mund të mrizojnë delet apo dhitë në mriz të tjetrit, gjithmonë të fisit, caktuar me vendim të fshatit përkatës. Po ashtu, rregull ka edhe për të bërë kripjen e ba-



gëtisë (për t'u hedhur kripë), që bëhet nëpër gurë të rrafshët (rrasa guri), që në gjuhën e popullit quhen gjollë (në jug gjollë). Çdo stan apo fis ka mgjollët e veta dhe nuk ka të drejtë kush t'u hedhë kripë në atë vend, njëlloj sikur për mrizet. Ai që prishte këto rregulla dënohet sipas vendimeve të fshatit. Nëse një bari del kundër vendimeve vetëm për një aktivitet, si paralajmërim, atij i digjej vatha e bagëtive dhe, nëse e përsërit atij i ikën e drejta për verim përgjithmonë në atë bjeshkë. Po ashtu, njerëzit ishin të ndërgjegjësuar, jo nga frika e dënimeve, por nga domosdoshmëria ose nga obligimi që ka ai kundrejt shoqërisë.

Stani i zakonshëm ndërtohej nga një familje, por kapaciteti i tij ishte i kufizuar; kështu veprohet edhe në ditët tona. Në këtë lloj stani zakonisht del e gjithë familja, bilë edhe numri i godinave varet nga kurorat që ka familja; godinat vendosen përreth stanit, ku gatuhet dhe përpunohen produktet e nënproduktet. Në disa fshatra dilnin në bjeshkë për verim por me vendim të fshatit, nuk kishin të drejtë për të ujitur, sepse ishte vendimi për të ujitur në fshat më poshtë dhe në fshat kishte të tjera vendime për mënyrën e ujitjes. Nëse një që ndan vadën e fshatit dhe ujit tokën në stan, atij i prishej e mbjella dhe kopshtet, duke ia shkullur e punuar tokën me komision.

Në disa fshatra dilnin në stane, por këtyre u thoshin stane baqi, si psh, në Kolosjan (Spahija), Çaj, Kala e Dodës. Në këto stane dilnin nga mesi i muajit deri në korrik, pasi në këtë kohë edhe moti ishte i përshtatshëm. Prandaj disa bjeshkë edhe sot kanë emrin e atij që ka dalë në këtë lloj organizimi të stanit të baqit. Përmendim: Gropa e Shehit në Bjeshkët e Çajës, ku dilte vetëm fisi Shehu (kjo bjeshkë sot është në territorin e Kosovës), po ashtu Kepi i Canit, Xhirbet e Palushit, sepse në këto xhirbe dilte Zenun Palushi nga Bushtrica, por vendin e paguante në baze të tarifave të asaj kohe.

Dallimi i stanit të zakonshëm me stanin e baqit është shumë esencjal: Ato kanë një bari për delet ose dhitë, një për qengjat ose kecat dhe një për të trashat, lopët dhe qetë e zgjedhës (një për çdo tufë tek i zakonshmi). Por ky bari

paguhej në bazë të numrit të krerëve në total, të leshta, të dhirta, gjedhë e njëthundrakë. Edhe sasia e qumështit ndryshon nga njëri stan në tjetrin. Shembull: Një stan i zakonshëm me një tufë prej 200 krerë dele që mileshin dhe një stan baqi me një tufë prej 7000 krerë dele, nga të cilat mileshin 5000 dhe 2000 ishin shterpa, si dhe 350 gjedhë, që kërkonin nga 250 lekë/kokë për t'i ruajtur gjithë sezonit e verimit. Në këtë stan kishte 7 veta vetëm për të mjelë delet dy herë në ditë, pasi nuk milen tri herë sikur milen në stanin e zakonshëm. Karakteristike ishte se në këtë stan përgjegjësit të stanit i thërrisnin "Qehaja", i cili përgjigjej për gjithçka. Çdo tufë që shkante në këtë stan kishte matrikullimin e



vet ose siç i thoshin të vjetrit katranin e vet me një lloj shenje në vesh dhe me një numër në shpinë me katran (prej pishe ose bitumi) në formë dhe shenje karakteristike, që i thonë damkë.

Në stanin e zakonshëm bëhej çdo produkt e nënprodukt, kos, gjizë, gjalpë, djathë etj., kurse në stanin e baqit prodhohej vetëm djathë e rrallë gjalpë. Qumështi milej në enë prej druri, që thirreshin shtrungë. Vendi ku mileshin delet ishte i thurur me gardh prej druri me hunj e thupra ose me dërrasa e listela, me formë e madhësi të ndryshme, edhe në bazë të numrit të krerëve. Delet që mileshin nuk mbylleshin në vathë si tek stani i zakonshëm por ruheshin natën në xhirbe (vend i kulluar e i rrafshë), pasi aty flinin më rehat dhe ishin më pastër. Qumështi përpunohej djathë, vetëm linin sa për nevojat e barinjve dhe të bagjejrave që punonin në stan dhe barinjtë për kos. Qumështin e përpunonin djathë baqi (i përafërt me kaçkavallin). Ja si veprohej për këtë: Me t'u mjelë qumështi kullohej nëpër napa (mësalla) dhe e hidhej në voza të mëdha ose siç i quanin ndryshe (sheka, korbulla ose ftana). Për ta përpunuar djathin, karakteristike ishte se nxehta e tij bëhej me gurë të nxehtë e jo me zjarr (në kazanë) sepse sasia e druve të zjarrit ishte shumë e kufizuar në këto vende dhe enët mungonin. Prandaj, nxehtshin gurët (dy apo tre copë) me një masë të caktuar dhe lëshoheshin në voza. Hidhej sasia e farës se djathit dhe përzihet; më shumë nga fara tradicionale, që behej vetë nga fermerët, që përgatitej nga mullëza e qengjit ose kecit pirës. Në mullëz hidhet një sasi qumështi dhe lidhet gryka hermetikisht e thahet për vitin pasardhës. Pasi qumështi pritej (mpiksej) përzihet ashtu i

butë dhe nxirrej nëpër kallëpe për kullim, të cilët vendoseshin nëpër dërrasa dhe kripeshin.

Në stanin e baqit nuk gatuanin bukë, por sipas rregullit të vjetër vetëm kaçamak, sepse në bjeshkët e mëdha nuk kishte sasi të mjaftueshme dru zjarri dhe, ana tjetër, në bjeshkë buka e misrit prishet shpejt, kurse kaçamaku rrinte ashtu si gatuhet; ai bëhej me miell misri për rreth 45 minuta. Preferohej të gatuhet me miell misër vendi. Kaçamaku gatuhet për dy ditë në një napë (mësallë) të varur për pastërti dhe ajrosje.

Në stanin e baqit, kur u duhej ndonjë punëtor, i vinin për të hëngër nga kaçamaku që hanin vetë (merreshin në provë dy punëtorë) dhe, atij që hante shpejt e shpejt i thoshin prit një minutë, kurse atij tjetrit, që hante ngadalë e shikonte anash ... kur mbaronte i thoshin se kemi gjetur punëtorë, na vjen keq.

Në stanet e zakonshëm nga mesi i gushtit - fillimi i shtatorit, delet i qethnin dy herë, sepse leshi ishte shumë i kërkuar për të bërë rroba shajaku. Në disa fshatra qethja bëhej edhe si tip ceremonie, gjë që vazhdon edhe sot. Psh, në Ujmisht delet qethen me 6 shtator, kurse në Lusën me 9 shtator. Një ditë përpara i lanin dhe të nesërmen i qethnin e bënin një drekë ose darkë. Qethja bëhej me gërshtë të posaçme të



prodhuara prej farkëtarëve të zot e me përvojë, shumë barinj e bënin porosinë për gërshtë delesh nëpërmjet atyre që shkonin në Greqi për dimrim (në Selanik) prandaj edhe sot thuhet gërshtë Selaniki. Qethja bëhet me forma e modele të ndryshme (me lugje, me tufa, me kaçube).

Në qoftë se një dele sëmurej apo kishte ndonjë problem, çobani e priste dhe e thante (e bënte pastërma) dhe i vinte damkën që kishte delja në shpinë e gjallë në mish në bazë të damkës dhe kishte për detyrë për t'ia treguar dhe lëkurën me gjithë shenjen në vesh që kishte ajo tufë. Shpërndarja e tufave bëhej me radhë dhe në ditë të caktuar nga qehajai, për të mos krijuar mosmarrëveshje dhe për të dorëzuar numrin e krerëve sipas rregullave të stanit, sidomos për stanin e Baqit. Po atë datë merrnin edhe bulmetin e grumbulluar gjatë verës, në bazë të numrit të krerëve që kishte secili.

## Deti Mesdhe dhe mjedisi përreth

- Vende si Izraeli janë model në përdorimin e ujit në kushte të kufizuara.
- Shqipëria mjaft e privilegjuar për sasinë e ujërave që ka.
- Nga 54 dete që ka globi, 7 i ka Mesdheu; nga dy dete laget Shqipëria (Joni dhe Adriatiku).

Mesdheu është ndër detet më të rëndësishëm e të veçantë të planetit. Ai dallohet nga thellësia, klima, tejudukshmëria, kaltërsia, peizazhi, gjelbërimi gjithëvjetor, ishujt,

qytetërimet, kur dihet se rreth 70 % e legjendave, baladave, miteve e gojëdhënave kanë bazë detet e Mesdheut, kryesisht Jonin e Adriatikut. Mesdheu bashkon shtrirjen e tre kontinenteve, Evropën,

Azinë dhe Afrikën. Ai ka një sipërfaqe prej 2.5 milionë km<sup>2</sup>; thellësia mesatare e këtij deti është 1.500 m, ndërsa maksimalja 5.123 m. Lidhja me oqeanin Atlantik bëhet nëpërmjet Gjibraltarit. Bilanci i ujit është negativ; uji që largohet nëpërmjet avullimit është 2.7 herë më shumë se ai që e ushqen atë. Mesatarisht në këtë det derdhen rreth 16.000 m<sup>3</sup>/sek. Është për t'u theksuar se vendi ynë derdh rreth 1200 m<sup>3</sup>/sek (rreth 7.5 %).

Siç dihet, në brigjet e Mesdheut janë vendosur 23 shtete të vendosur horizontalisht, ndërsa vendi ynë është i vendosur vertikalisht (lartësia mesatare 704 m).

Shqipëria për 365 ditë derdh në detet e Mesdheut rreth 37

miliardë m<sup>3</sup> ujë (80 % e këtij uji janë burime mbi 900 m lartësi nga deti, përjetësisht te pashtershëm e të pa ndotur. Nga UNESCO, do ishte me interes mbështetja institucionale e njohjes së kësaj pasurie me kaq vlerë. Ujërat që derdhen në detet e Mesdheut nga shume shtete kanë shkallë të lartë ndotjeje, pasi kanë kryesisht origjinë urbane. Kjo bën që Mesdheu të renditet ndër detet më të ndotur të globit. Sot ka të dhëna që në Mesdhe gjatë një viti derdhen rreth 30.000 tonë merkur, plumb, krom e xing dhe jo pak hidrokarbure. Shkalla e ndotjes është e lartë edhe nga depozitimi i mbetjeve të fosforit, nitrateve etj. Kërkimet shkencore kanë provuar

me argumente se ndotja e mjedisit është një proces i mirëfilltë natyror, ne një shtrirje gjeografike tepër të gjerë, që s'njeh kurrfarë kufiri shtetëror. Kjo bën që të pësosh ndotje edhe pa qenë vet shkaktar.

Që Mesdheu të jetë sa më i pastër, lypset që çdo shtet të këtë përgjegjësi për ruajtjen e tij.

Vendi ynë, për pozicionin që mban, për resurset që ka dhe kontributin që ka në këto dete duhet të këmbëngulë që të mbështetet sa më parë nga institucionet që kanë marrë përsipër njohjen dhe ruajtjen e vlerave të Mesdheut.

Ahmet OSJA

## The Forest and reforms in reality and in newspaper

The open current debate on the newspaper, and on the page of the social media, regarding with what is happening with the Forests reform in Albania, indirectly is a discussion for the functioning of our democracy.

This not only because the media is one of the "powers" of democracy, but also because through media, the society (public opinion) realizes its control over the other powers.

Due to the mission of this newspaper as the transmitter of a the opinion of society, it as opinion maker, why not, should even be felt responsible for the reality.

Yes, but, someone will tell me, the power does not care about what you say, words are not strong anymore, the society reacts little and is not at the right level against the unresponsibility of individuals in institutions with no mission.

If we have this situation in the forests and environment, if the informality goes on, if the laws do not apply, if the forests are burned and cut, I can not understand how the economic journalists work without any reliable statistics. Obviously the state institutions have the responsibility because they are paid for this information but doesn't the press have any responsibility at all?

Nobody knows how many hectares of Forests and Pastures there are in Albania, how much forests and pastures are grown and cut because there is a lack of analysis and updates even though several experts are paid by the Albanian taxpayers... many of them compare the forests with a treasure, but nobody replies how much they have in the bag?

So it is difficult to establish a sufficient economic base to give to the people that quality of life that they deserve as well as a governance based on the progressive concept of division of property. This has not happened and it is difficult to be realized with the policies of the years 1988 which said "to be given to villagers two sheeps or two kids (young goat), which both were female or both male because otherwise they spawn capitalism".

The theories: according to which for the bad condition of forests, land and erosion is the farmer's fault because we are giving them the forests which they cut, are corrupted, mediocre, are nothing but an excuse of pseudospecialists, pseudopoliticians, who can not find themselves in the market but try with demagogic ways under the guise of parties to endanger the whole process and distort the results of all these years.

We want everyone to join us, to join the farmers' opinions and requests that the forest are and will be their property and the farmers are the owners.

We, and the newspaper are impartial, we verify, and we are part of what happens in the field, we do not act just by listening, without proving, we deliver real practices, tangible and visible experiences to everyone, he who does not believe us today, will believe us tomorrow it then will be late...and who loses? All, people, forests, land, environment, air, economy and sustainable development...

Page 1, 2, 3



## The past and the future of Rugova

from Ramiz QORRAJ

Page 4, 5

## Kosova offers opportunities for rural tourism development

from Ardita DINAJ

## Community care will lead to sustainable development for forests

New project: Municipalities being 'owners' would save the forests from destruction

An interview with Ahmet MEHMETI, forest engineer

Era ÇELA

Transfer of state-owned forests to local government and community would help the forest development. Forest engineer Ahmet Mehmeti, a specialist with experience in the district of Elbasan, says in an interview with the newspaper "Telegraf" that

the project will help a lot in protecting from abuses. Furthermore, he speaks about the importance of this transfer, for the resources of the area and their protection, and for a sustainable development. During the interview he puts emphasis the work of the municipalities as 'owners', but he also notes the fact that the municipality still has problems regarding administration borders ...

Page 1, 4, 5



## Tradition continues

from Ilmi GJANA

## In high mountain pastures of Kukës Life in high mountain pastures settlements during summer

With the emergence of spring, in the villages and high mountain pastures (bjeshke) there have been a tradition, which nobody could change. On the 6<sup>th</sup> of May, or as people called it "the day of Shengjergj", several significant ceremonies were made. In the early morning all the residents awoke and went to get green tree branches, and establish them in their properties, in fields and meadows, and also in gardens. They did this to show that the properties had a owner. They did the same thing in the high mountains pastures (bjeshke). Everybody put a green branch, so whoever

watched that branch would not have the right to feed his cattle in that field. Each family with the user right for the high mountain pastures, used them all the season, grouped in interim settlements (stane) by some families or one family alone. The pasture area was assessed by the special measurements unit (the number of sheep to graze) for example 500 sheep, was an area with grazing capacity by 500 sheep. In other side the area of the pasture used for mow was measured by the number of the workers needed to mow all the area on one day called "kose" ...

Page 7



## About ownership and management of south pastures

Vjola ELEZI

Association Building Specialist, United Nations Development Programme (UNDP)

Pastures and meadows in southern Albania occupy a considerable area and are inextricably linked with the forests. This dictates the way of managing in the complex of management and administration. Usually the pastures from Konispoli to Vlora are used all the year. These pastures are represented from large areas covered with grass. But, as for some years anything was done to improve them, they are often covered with harmful bushes. That's why the residents burns this pastures to clean them and to create opportunities to renew the grass for the autumn. These hills covered with pastures, are used to feed the cattle by the community, but they have also been given for seasonal rent to clients outside the municipality by the Directorate of Forest Service ...

Page 3



Kjo faqe u përkthye e u përgatit për botim nga Blerina KOLA

### KURORA E GJELBËR

Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, Shqipëri dhe e Asosacionit të pronarëve Privatë, Kosovë

Këshilli Botues: A. Proko, N. Çollaku, V. Tabaku, J. Male, B. Gashi, I. Zeka, B. Hoxha

Kryeredaktor: AHMET OSJA      Zv.kryeredaktorë: Nijazi IDRIZI, Ferdin LIÇAJ, Albora KACANI

Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, M. Shehi.      Redaktor përgjegjës: V. Hoxha

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina e ZP, kati II, Tiranë

Mobile: 068 40 75 975; e-mail: fkpkk@hotmail.com; velihoxha@yahoo.com

www.fkpkk.org

www.akppp.org

**SNV**  
Connecting People's Capacities

**Sida**